



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS  
MUNICIPALITY OF KLINA  
OPŠTINA KLINA



[www.komuna-kline.org](http://www.komuna-kline.org)

## Kuvendi i Komunës Klinë

### Komiteti për Komunitete

01Nr. OG-15089 2022

Klinë, dt. 08.05.2023

### PROCESVERBAL

Nga mbledhja e rregullt e punës së Komitetit për Komunitete të mbajtur me datë 12. 04. 2023 në ora 10:00 në Sallën e Kuvendit të Komunës.

Mbledhjen e Komitetit për Komunitete e hapi kryesuesja e Komitetit, znj. Besiana Gashi, e cili përshëndeti të pranishmit dhe prezantoi Rendin e Ditës,

### RENDI I DITËS

1. Arsyetimi i mungesave.
2. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit të mbledhjes së fundit.
3. Informim nga DKA rreth procesit mësimor të Komunitetit
4. Informim nga zyra për komunitete dhe kthim.
5. Të ndryshme.

Rendi i Ditës u Aprovua me 6 vota për asnjë kundër dhe asnjë apstenim.

#### Pika 1 e Rendit të Ditës: Arsyetim i mungesave

U konstatua se të pranishëm janë 6 anëtarë të komitetit dhe se për anëtarin e 7 –të janë akoma në pritje për ligjshmërinë e vendimit

#### Pika 2 e Rendit të Ditës: Procesverbal i mbledhjes së kaluar u aprovua me 6 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim

#### Pika 3 e Rendit të Ditës: Informim nga DKA rreth procesit mësimor të Komunitetit.

Për këtë pikë të rendit të ditës fjalën e merr z. Astrit Muhaxheri

z. Astrit Muhaxheri, DKA: Përshëndetje. Ne gjithmonë flasim bazuar në të dhënat që janë në sistemin SMIJA. Deri tani janë në procesin mësimor 241 nxënës minoritar. Shkollat në qytet kanë numër më të madh të nxënësve. Numri i rënies është në kuadër të numrit të përgjithshëm të rënies së numrit të nxënësve. Deri me

tani nuk ka të raportuar si nxënës braktisesh nga minoritarët, të paktën nuk janë raportuar në sistemin SMIJA, nuk janë gjeneruar të dhënat ndoshta. Sa i përket bursave, nuk ka akoma konkurs, do të ketë gjithsesi.

**z. Nexhmedin Gashi:** Përshëndetje gjithë të pranishmit. Dëshiroj të pyes nëse janë rikthyen në shkollë nxënësit e lagjes Klinac?

**z. Astrit Muhaxheri, DKA:** Sa i përket atyre nxënësve, ne kemi punuar shumë me ta. Duhet të punojmë të gjithë bashkërisht që ta vejmë në rregull këtë punë. Nevojat që ka pasur mundësi që të i mbuloj drejtoria e arsimit është munduar që të i mbuloj. Por rendësi të madhe të vijueshmërisë së nxënësve në shkollë ka prindi. Sipas informatave që vijnë nga shkolla ata nxënës të minoriteteve nga Klinaci vazhdojnë njëte të mos vijojnë procesin mësimor. Është përfaqësuesi i zyrës për komunitete, z. Halil Kerellaj që ka bashkëbisedim të vazhdueshëm me prindërit e atyre fëmijëve.

**z. Nexhmedin Gashi:** Edhe herën e kaluar e kam ngritur si çështje pa pastërtinë në shkollën fillore në Grabanicë. Edhe pse kemi pasur premtimë që do të rregullohet, gjendja nuk ka ndryshuar. Para një jave ka qenë një aktivitet dhe me hidroforë kanë marr ujin nga proçka afër aty ku derdhen gypat e kanalizimit të fshatit dhe e kanë pastruar shkollën brenda. Mu ka dukë gjest shumë i dëmshëm.

**z. Astrit Muhaxheri, DKA:** Ka qenë një problem me kanalizim vitin e kaluar në atë shkollë dhe edhe pse jemi munduar ta rregullojmë një pjesë prap e njëjtë gjendje është. Sipas eksperteve era e rënë më së shumti vjen nga gypat e vjetër. Tani investime nuk mund të kemi shumë aty sepse veç se jemi duke kaluar në shkollën e re që s`do ti kemi këto probleme.

#### Pika 4 e Rendit të Ditës: Informim nga zyra për komunitete dhe kthim

**z. Halil Kerellaj, ZKK:** Përshëndetje. Dëshiroj të ndërlidhem për bursat. Sa për informim pjesëtarët e komunitetit që shkojnë në shkollë të mesme e kanë një bursë të veçantë që e marrin nga Ministria e arsimit. Për momentin i kemi 11 përfitues të atyre bursave. Sa i përket zyrës sonë, përpos pritjes së palëve të vazhdueshme duke marr kërkesa të ndryshme për ndihmë kemi pasur edhe një projekt përenovim të shtëpisë por që nuk ka kaluar përmes prokurimit sepse kompanitë që kanë konkurruar kanë qenë mbi vlerën e planifikuar. Tani së shpejti do ta bëjmë ri procedimin e këtij tenderi. Po ashtu kemi një përfitues të komunitetit nga projekti INTEGRA, në vlerë prej 2000 euro. Po mendohet që të ndërtohet një qendër e komunitetit ku në atë qendër pjesëtarë të komunitetit do të kenë mundësi të aftësimit për profesione e zanate të ndryshme.

**z. Vehbi Alaj:** Dëshiroj të dijë nëse ka ndonjë përfitues nga komuniteti të serave. Po ashtu çfarë ka sjell takimi i znj. Raskovic me ish presidenten Jahjaga? Për shtëpinë e djegur në Rudicë?

**z. Halil Kerellaj, ZKK:** Sa i përket serave është një përfitues i komunitetit Egjiptian ndërsa sa i përket takimit nuk jam në dijeni. Deri tani për shtëpinë e djegur nuk ka asgjë.

**z. Arben Limanaj:** Përshëndetje. A keni informacion se a ka ndonjë student minoritar që është duke vazhduar studimet e larta.

**z. Halil Kerellaj, ZKK:** Në vitin 2019 kemi pasur 18 student, ndërsa tani i kemi diku 5 studentë dhe një në master. Kushtet janë të mira, bursat nuk mungojnë por numri ka rënë.

**z. Nexhemedin Gashi:** Nëse ka informata z. Kerellaj se sa janë fermer nga komuniteti që merren me bujqësi. Tani ka qenë e hapur mundësia për aplikim për subvencione , a kanë aplikuar ndonjëri?

**z. Halil Kerellaj, ZKK:** Po kanë qenë të informuar por numri i aplikantëve ka qenë i vogël, afërsisht 5 familje kanë aplikuar për subvencione.

**Pika 5 e Rendit të ditës: Të ndryshme.**

**Pasi që nuk kishte asnjë debat për pikën e fundit, zonja Gashi falënderoj të gjithë për pjesëmarrje dhe kontribut dhe e shpalli të mbyllur mbledhjen.**

Procesmbajtës:

Skënder Behramaj

